



**Republika e Kosovës**  
Republika Kosova – Republic of Kosovo



**Komuna e Mitrovicës së Jugut**  
Opština Juzna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South

**KUVENDI I KOMUNËS SË MITROVICËS SË JUGUT**

**Komiteti për Komunitete**

**Nr. 02-060/01-0013160-1/24 dt. 29.02.2024**

**Mitrovicë**

**PROCESVERBAL**

**Nga mbledhja e rregullt e Komitetit për Komunitete**  
**Seanca e 25-të**

**Koha:** 29.02.2024 ora 15:00  
**Vendi:** Salla e Mediave  
**Të pranishëm:** Kryesuesi i Komitetit z. Jeton Rrahmani  
Anëtarët e Komitetit për Komunitete: Xhafer Preteni, Majlinda Kurti, Elidiana Budini Haziri, Xhevrije Bahtiri Ademi, Gazmend Asllani, Ardita Aliu, Agron Jashari, Esat Krasniqi, Habib Hajdini dhe Edina Sejdiu Hamzagic

**Mungoi:**

Mbledhjen e hapi dhe kryesoi Kryesuesi i Komitetit i cili fillimisht përshëndeti të pranishmit dhe theksoi se në zbatim të nenit 51, paragrafi 2, të Ligjit Nr. 03/L-040 Për vetëqeverisje lokale; nenit 61, paragrafi 2, dhe nenit 62, të Statutit të Komunës; nenit 12, paragrafi 1, të Rregullores për punën e Kuvendit; nenit 14, paragrafi 3, të Rregullores për punën e komiteteve të Kuvendit; për sot kam thirrur mbledhjen e rregullt të Komitetit për Komunitete me këtë:

**REND DITE:**

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar
2. Diskutim lidhur me ruajtjen dhe mbrojtjen e identiteteve dhe vlerave etnike, kulturore, fetare, mendimit politik dhe çfarëdo mendimi tjetër pavarësisht nga përkatësia etnike

***Rendi i ditës u miratua unanimisht***

**Pika 1**  
**Procesverbali nga mbledhja e kaluar u miratua unanimisht.**

**Pika 2**

Kryesuesi i Komitetit z. Jeton Rrahmani sa i përket Diskutimit lidhur me ruajtjen dhe mbrojtjen e identiteve dhe vlerave etnike, kulturore, fetare, mendimit politik dhe çfarëdo mendimi tjetër pavarësisht nga përkatësia etnike, e hap diskutimin.

Esat Jashari: Sa i përket shqetsimeve tonat si komunitet ka kohë që ne kemi kërkar që të punësohet një punëtorë nga komuniteti jonë, na është premtuar por në realitet nuk ka asgjë dhe ende as nuk është hapur ndonjë konkurs për atë qëllim, pastaj zyra e ZKK-së është mjaft e vogël ne e dimë se në komunë ka zyre të mëdha dhe po bëhen ndryshime vazhdimisht pra atëherë pse mos me ju mundësu edhe ZKK-së, nuk është në rregull vetëm pse është zyre për komunitete të lihen krejt në një zyre në një hapësirë aq të vogël. Po ashtu kërkesa jonë ka qenë që sa kohë që të rregullohen shtyllat në lagjen 2 Korriku sepse ato janë të dëmtuara dhe kemi mungesë të ndëriqimit.

Habib Hajdini: Problemin kryesor e kemi ndëriqimin publik, pra mungon shumë dhe disa herë kemi bërë kërkesa po nuk është ndërmarrë asgjë në atë drejtim. Po ashtu kemi probleme edhe të kanlaizimit, të mbeturinave të çenëve endacak të cilët i sjellin dhe i lëshojnë tek lagjia.

Kryesuesi i KpK z. Jeton Rrahmani sa i përket ndëriqimit publik nëse pajtoheni edhe ju të dalim me një rekomandim për drejtorinë përkatëse dhe të na tregojnë se çka po ndodh pse nuk po rregullohet ndëriqimi.

Kryesuesi i Komitetit z. Jeton Rrahmani atëherë hedh në votim Rekomandimin:


Komiteti për Komunitete i Rekomandon Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe Infrastrukturës që të rregullohet ndëriqimi publik në lagjen “Adem Voca” dhe në lagjen “2 Korriku”.

**Komiteti për Komunitete miratoj unanimisht Rekomandimin e propozuar.**

**Mbledhja përfundoj punimet në ora 15:40 min.**

Mitrovicë  
29.02.2024

Procesmbajtës:  
  
Afërdita MAXHUNI

Kryesuesi i Komitetit  
  
Jeton RRAHMANI